

VENDIM
Nr.962, datë 24.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR,
PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si autoritet kontraktor, të përfundojë procedurat e prokurimit, me objekt “Rikonstruksioni i mjediseve të AKSHI-it (ish – ndërtesa e INIMA-s), për krijimin e “DATACENTER”, qendra e përqendruar e shërbimeve të qeverisë shqiptare”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitet 2010, 2011 e 2012, si dhe të nënshkruajë kontratën me ofertuesit fitues, brenda datës 30 dhjetor 2010.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha